



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E ISTOG

KONTRATË

Numri i kontratës: 633-25-5166-5-2-1/C1032

KOMUNA E ISTOGUT, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

Grup i Operatorëve Ekonomik NISI ING SH.P.K.; Valdrini sh.p.k; Benita Company, Peje, Peje, (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

LOT1- NDERTIMI I RRUGEVE NE PRIGODE, LAGJA GASHI MEHAJ. LOT2- NDERTIMI I RRUGES SHABAN HAJZERAJ NE LLUKAFC TE THATE. LOT3- NDERTIMI I RRUGES NE LLUKAFC TE THATE. LOT4- NDERTIMI I RRUGES KAMER LOSHI NE VERIQ.(PROJEKTE 2VJEQARE)(633-025-028-521) me numër identifikues: 633-25-5166-5-2-1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit: LOT1- NDERTIMI I RRUGEVE NE PRIGODE, LAGJA GASHI MEHAJ. LOT2- NDERTIMI I RRUGES SHABAN HAJZERAJ NE LLUKAFC TE THATE. LOT3- NDERTIMI I RRUGES NE LLUKAFC TE THATE. LOT4- NDERTIMI I RRUGES KAMER LOSHI NE VERIQ.(PROJEKTE 2VJEQARE)(633-025-028-521)

Nr. I prokurimit	633-25-5166-5-2-1/C1032
I brendshëm	633-25-028-521

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve për të gjitha lotot duhet të jetë: 344,257.50 €; (me fjalë)
"Treçindekatërdhjetekatërmijëedyçindpesedhjeteshtatë-50/100 Euro.

Çmimi per LOT1- NDERTIMI I RRUGEVE NE PRIGODE, LAGJA GASHI MEHAJ. Duhet te jetë: 38,129.00€

Çmimi për LOT2- NDERTIMI I RRUGES SHABAN HAJZERAJ NE LLUKAFC TE THATE. Duhet te jetë: 137.842.00€

Çmimi për LOT3- NDERTIMI I RRUGES NE LLUKAFC TE THATE. Duhet të jetë: 46,810.50€

Çmimi për LOT4- NDERTIMI I RRUGES KAMER LOSHI NE VERIQ. Duhet të jetë 121,476,00€

Për LOT 1 LOT1- NDERTIMI I RRUGEVE NE PRIGODE, LAGJA GASHI MEHAJ.Kontrata ne mes paleve do te lidhet per Shumen e zotimit te mjeteve per vitin 2025 ne shumë prej 15,000.00€ ndersa shuma prej 18.129.00€ do te realizohet ne vitin buxhetor 2026.

Per LOT 2 Kontrata në mes te palëve do të lidhet ne shumë te zotimit per vitin 2025 shuma prej: 30,000.00€ ndrsa shuma tjetër prej 107.842,00€ do te realizohet ne vitin buxhetor 2026

Për LOT3- NDERTIMI I RRUGES NE LLUKAFC TE THATE. Kontrata ne mes te paleve do te lidhet ne shumë prej 30,000.00€ ndersa shuma prej 16.810,00€ do te realizohet ne vitin buxhetor 2026

Për LOT4- NDERTIMI I RRUGES KAMER LOSHI NE VERIQ. Kontrata ne mes paleve do te lidhet ne shumë te zotimit te mjeteve per vitin 2025 prej 30.000,00€ ndersa shuma e mbetur prej 91.476 € do te realizohet ne vitin buxhetor 2026.

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhe në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

Oferta financiare (Përshkrimi i Çmimeve);

Plani për menaxhimin e kontratës

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4. Afati i permbytjes së kontratës:

*4.1 Të gjitha punimet rreth aktivitetit në fjalë do të fillojnë pas nënshkrimit të kësaj kontrate dhe të planit për menaxhimin të kontratës dhe do të përfundojnë me se voni deri **me 30.11.2026***

Neni 5 Komunikimet:

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimin të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimin të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.



5.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën SHQIPE në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një për kontraktuesin.

Per Autoritetin Kontraktues:

Për Kontraktorin:

Komuna e Istogut

G O E NISI ING SH.P.K.; Valdrini sh.p.k; Benita Company

Emri:	Gëzim Ademaj	Emri:	Alberin Zogaj
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit	Pozita:	PI L i d e r - i N P E R
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	16/09/2025	Data:	16.09.2025
Vula:		Vula:	



KUSHTET E PËRGJITHSHME

Numri i kontratës: 633-25-5166-5-2-1/C1032

Neni 1 Përkufizimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Kontraktuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 "Punë" konsiderohen të gjitha ato punë të cilat janë objekt i kontratës dhe të cilat Autoriteti Kontraktues kërkon që të kryhen nga kontraktuesi, qofshin ato ndërtim, restaurim, meremetim apo rrënim ndërtesash, pajisje, struktura inxhinieringu civil, struktura të tjera apo pjesë të tyre.

1.3 "Kontraktuesi" është operatori ekonomik (apo grupi i operatorëve ekonomik), i caktuar në formularin e kontratës, i cili (të cilët) është palë në kontratë dhe është i obliguar të kryejë punët sipas marrëveshjes dhe i cili do të marrë shumën sipas marrëveshjes me kontratë.

1.4 "Menaxheri i Projektit" është njeriu i caktuar në kushtet e veçanta të kontratës (apo cilido njeri kompetent i autorizuar nga Autoriteti Kontraktues), i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së punëve dhe për të gjitha hollësitë duhet t'i raportojë Autoritetit Kontraktues.

1.5 "Çmimi Kontratës" do të thotë shuma që i paguhet Kontraktuesit sipas marrëveshjes në formularin e kontratës.

1.6 "Vendi i ndërtimit" do të thotë vendi i caktuar për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.7 "Pajisjet e kontraktuesit" do të thotë e tërë makineria përfshirë edhe atë për bartjen e pajisjeve, dhe mjetet tjera që nevojiten për kryerjen e punëve të kontraktuara që duhet të bëhen sipas kontratës.

1.8 "Skicat" nënkuptojnë vizatimet, llogaritjet, informatat e siguruar dhe të miratuara nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.9 "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Kontraktuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Kontraktuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Kontraktuesit, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Kontraktuesit siguresve të Kontraktuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguresit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Kontraktuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Kontraktuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Kontraktuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Kontraktuesi nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideron si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Kontraktuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Kontraktuesit, agentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Menaxherit të Projektit nuk e liron Kontraktuesin nga obligimet e tij sipas kontratës.

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Kontraktuesit, përkitazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Kontraktuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

OBLIGIMET E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Neni 5 Dhënia e dokumenteve

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Kontraktuesit, pa pagesë, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Kontraktuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato janë në dispozicion. Pas lëshimit të certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi duhet ti kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Kontraktuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Kontraktuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.

Neni 6 Qasja në vend punishte

6.1 Autoriteti kontraktues, në kohën e duhur dhe në përputhje me ecurinë e punimeve, do ti jap qasje dhe akses Kontraktuesit në vend punishte, në përputhje me programin e zbatimit të detyrave të përcaktuara në këto Kushte të përgjithshme.

6.2 Kontraktuesi, gjatë shfrytëzimit, duhet të mirëmbaje çdo objekt të vendosur në dispozicion të tij në gjendje të mirë, dhe duhet, nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktues, ti kthej ato në gjendjen e tyre origjinale pas përfundimit të kontratës.

6.3 Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë të ndonjë pagese për përmirësimet që rezultojnë nga puna e kryer me iniciativën e tij.

Neni 7 Ndhurma lidhur me rregulloret vendore

7.1 Kontraktuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhërat apo ligjet anësore të Republikës së Kosovës të cilat mund të ndikojnë te Kontraktuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kërkuar Kontraktuesit me shpenzime të Kontraktuesit.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 633-25-5166-5-2-1/C1032

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë GJUHA SHQIPE
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është 10% e vlerës së kontratës, me vlefshmëri 30 ditë me gjatë se perfundimi i kontratës.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: Sigurimi i vend punishte do te jete përgjegjësi e Operatorit Ekonomik dhe te gjitha dëmtimet e punëve, dëmtimet e pronës apo humbjet e materialeve dhe pajisjeve ne vend punishte janë ne përgjegjësi te Operatorit ekonomik deri ne shumen e dëmtimeve apo humbjeve, sigurimi i vend punishte do te jetë + 30 dite nga plani dinamik i ofruar pra nëse zgjasin punimet zgjatet edhe sigurimi i vend punishte pra + 30 dite.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të caktohet në planin e menaxhimit-Pas nënshkrimit të kontratës.
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 60 ditë pune, e me se voni deri me 30. 10 .2026 pas nënshkrimit te kontratës dhe planit te menaxhimit te kontratës.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha punët janë 0.25% për çdo ditë vonese, por jo më shume se 10% e vlerës së kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Ditari i Punës dhe Libri ndërtimor dhe dokumentacioni tjetër përkatës

<i>Inspektimi dhe testimi</i>	22.1	<i>Menaxher i kontratës do të jetë Kompanija P.M.N SHPK; N.P.N. "UNIVERS-MI" dhe mbikqyres i drejtëperdrejt z. Genc Ademaj, Drejtor i Zhvillimit Ekonomik i caktuar me kontratë Nr. 633-025-047-221 datë 12.09.2025 i cili do ta bëjë mbikqyrjen dhe realizimin e projektit deri ne perfundimin e tij si dhe do te punojnë planin për menaxhimin e kontratës.</i>
<i>Pagesat</i>	24	<i>Autoriteti Kontraktues duhet të paguaj Kontraktuesit shumën e certifikuar nga Menaxheri i Projektit brenda 30 ditëve nga data e çdo certifikate.</i> <i>Pagesat do te behen pas situacioneve për punët të përfunduara, ndërsa pagesa perfundimtare behet pas pranimit te gjitha punimeve pa verejtje.</i>
<i>Shkaqet për kompensim</i>	30.1	<i>Data e posedimit të vend punimit do të jetë 3 ditë pas nënshkrimit të kontratës.</i>
<i>Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve</i>	42.2	<i>Palët do të provojnë ne mënyrë miqësore ti zgjidhin marrëveshjet ku do të organizojnë se paku (2) dy takime për zgjidhje miqësore e nëse këto takime nuk kane sukses, atëherë kompetente do te jetë gjykata.</i>
<i>Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore</i>	43.1	<i>Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykata Themelore – Departamenti për çështje ekonomike Prishtinë</i>

NDERTIMI I RRUGËVE NË PRIGODË-Lagja Gashi-Mehaj					
NDERTIMI I "RRUGËVE NË Prigoë,L=130m dhe gjerësi b=3m dhe L1=86m dhe b=3m, L2=132m,b=3m,L3=70m,b=3m,L4=67m,b=3m.L5=93m,b=3m, Zgjerime S=50m²					
PARAMASA DHE PARALLOGARIA					
Gjatësia e rrugës :		L=580m	Gjerësia e asfaltit		b=3m
		Gjerësia e germimit:		b=4m	
Nr.	Specifikimi i punëve	Njësia (1)	Sasia (2)	Cmimi/ Njesi (3)	Gjithsejt (2x3)
1	INÇIZIMET DHE PUNËT PARAPRAKE NË TEREN				3,380.0 €
1.1	Mobilizimi i ndermarjes dhe rregullimi i punishtes per pune si dhe largimi i instalimeve te ndryshme (elektrike, uji dhe kanalizimi, ptk, kabllorike etj) ne punishte ne rast se ka ne ato hapësira dhe dislokimi i tyre ne vendet e caktuara nga institucionet perkatese. Te gjitha angazhimet dhe shpenzimet per dislokimin dhe rikyqjen e instalimeve ne rjetin e qytetit i bart operatori ekonomik.	copë	1.00	1,500.00 €	1,500.00 €
1.2	Vendosja e shenjave te perkohshme vertikale dhe shenjave per kontrole te trafikut gjate kryerjes se punimeve dhe sigurimi i komunikacionit gjate punimeve.	copë	1.00	1,000.00 €	1,000.00 €
1.3	Shenimi i trases si dhe percjellja e punimeve me matje gjeodezike gjate egzekutimit.	m'	580.00	1.00 €	580.00 €
1.4	Pastrimi i terenit ne pjeset anesore te ruges ne te dyja anet e saj nga shkuret, rrenjet e drunjeve egzistues me trashesi deri ne 40cm si dhe ndonje pengese eventuale (gardhet) etj.	m'	300.00	1.00 €	300.00 €
2	PUNËT TOKËSORE				4,408.0 €
2.1	Gërmimi i dheut te kategoris se III dhe IV me trashesi t=30cm, dhe bartja e materialit te germuar deri ne deponi me te afert.	m3	696.00	3.00 €	2,088.00 €
2.2	Nivelizimi dhe ngjeshja e nënbazes se rruges në tërë gjatësinë e saj me saktësi deri ne 2cm me grejder me modul te ngjeshjes 40-50MPa.	m²	2,320.00	1.00 €	2,320.00 €
3	KONSTRUKSIONI I TRASES SË RUGËS				30,341.0 €
3.1	Furnizimi, transporti, shtruarja, rafshimi dhe ngjeshja e materialit mbushes zhavorik te granular nga guri i thyer (0-63mm) me trashesi pas ngjeshjes t=15cm, ngjeshja te behet me cilinder 25tone deri ne modulin e ngjeshjes 50-60Mpa.	m3	348.00	12.00 €	4,176.00 €

Nr.	Specifikimi i punëve	Njësia (1)	Sasia (2)	Cmimi/ Njesi (3)	Gjithsejt (2x3)
3.2	Furnizimi, transporti, shtruarja, rafshimi dhe ngjeshja e materialit mbushës zhavorik të granulluar nga guri i thyer (0-31.5mm) me trashësi pas ngjeshjes t=15cm, ngjeshja të bëhet me cilindër 25tone deri në modulën e ngjeshjes 50Mpa.	m3	348.00	13.00 €	4,524.00 €
3.3	Furnizimi, transporti dhe punimi i shtresës së asfaltit me asfaltbeton AB-16, me trashësi 7cm pas ngjeshjes adekuate. Karakteristikat e asfaltit: fraksionet e asfaltit >2mm...45-82.5%, fraksionet e agregatit <2mm...27-49%, pjesa për mbushjen e poreve <0.09mm...3-6%, përqindja e filerit ndaj agregatit 4-10%, materiali lidhës - bitumen B50/70...5.3-6.5% dhe shkalla e ngjeshjes >97%. Garancioni i qëndrueshmërisë së Asfaltit duhet të jetë minimum 5 vjeçar prej ditës kur është bërë pranimi teknik i punimeve.	m2	1,800.00	10.50 €	18,900.00 €
3.4	Furnizimi dhe vendosja e leshesës gypore Ø600mm për kalësen e rrugës	m	10.00	60.00 €	600.00 €
3.5	Furnizimi dhe vendosja e leshesës gypore Ø400mm për kalësen e rrugës	m	6.00	40.00 €	240.00 €
3.6	Furnizimi dhe vendosja e leshesës gypore Ø800mm për kalësen e rrugës si dhe punimi i kokave nga betoni	m	5.00	80.00 €	400.00 €
3.7	Furnizimi me material dhe ngritja e pushtave për gatë rrugës-trasës dhe vendosja e kapave nga giza me aftësi mbajtëse 30ton.	copë	2.00	100.00 €	200.00 €
3.8	Marrja e mostrave të asfaltit për shqyrtim nga një laborator të caktuar nga autoriteti kontraktues (menaxheri i projektit) në vendet e caktuara po ashtu nga mbikqyrësi i projektit.	copë	5.00	25.00 €	125.00 €
3.9	Furnizimi dhe vendosja e sinjalizimit Vertikal nga qasja e rrugës dytësore e planifikuar për Asfaltim për kyqje në rrugën kryesore. Shenja e planifikuar është Shenja STOP e punuar sipas standardeve. Sinjalizimi të vendoset në rrugët dytësore që lidhen me rrugën kryesore.	copë	6.00	80.00 €	480.00 €
3.1	Furnizimi me material, transporti dhe shtruarja e bankinave në dy anët e rrugës me gjerësi nga 0.5m me trashësi 10cm pas ngjeshjes nga guri i thyer me fraksion (16-31.5mm).	m3	58.00	12.00 €	696.00 €

I. REKAPITULIMI		
1	INÇIZIMET DHE PUNËT PARAPRAKE NË TEREN	3,380.0 €
2	PUNËT TOKËSORE	4,408.0 €
3	KONSTRUKSIONI I TRASES SË RUGËS	30,341.0 €
I. TOTALI (1+2+3):		38,129.00 €

NDERTIMI I RRUGËS Shaban Hajzeraj në Veriq					
NDERTIMI I RRUGËS Kamer Shaban Hajzeraj L=1400m, b=4m, L1=130m,b=3m,L2=152m,b=3m,L3=180m,b=4m dhe L4=60m,b=3m dhe Zgjerime S=100m²					
PARAMASA DHE PARALLOGARIA					
Gjatësia e rrugës :		L=1922 m	Gjerësia e asfaltit		b=3mdhe b=4m
		Gjerësia e germimit:			b=4m dhe b=5m
Nr.	Specifikimi i punëve	Njësia (1)	Sasia (2)	Cmimi/ Njesi (3)	Gjithsejt (2x3)
1	INÇIZIMET DHE PUNËT PARAPRAKE NË TEREN				6,344.0 €
1.1	Mobilizimi i ndermarjes dhe rregullimi i punishteve per pune si dhe largimi i instalimeve te ndryshme (elektrike, uji dhe kanalizimi, ptk, kablovike etj) ne punishte ne rast se ka ne ato hapësira dhe dislokimi i tyre ne vendet e caktuara nga institucionet perkatese. Te gjitha angazhimet dhe shpenzimet per dislokimin dhe rikyqjen e instalimeve ne rrjetin e qytetit i bart operatori ekonomik.	copë	1.00	1,500.00 €	1,500.00 €
1.2	Vendosja e shenjave te perkohshme vertikale dhe shenjave per kontrole te trafikut gjate kryerjes se punimeve dhe sigurimi i komunikacionit gjate punimeve.	copë	1.00	1,000.00 €	1,000.00 €
1.3	Shenimi i trases si dhe percjellja e punimeve me matje gjeodezike gjate egzekutimit.	m'	1,922.00	1.00 €	1,922.00 €
1.4	Pastrimi i terenit ne pjeset anesore te ruges ne te dyja anet e saj nga shkuret, rrenjet e drunjeve egzistues me trashesi deri ne 40cm si dhe ndonje pengese eventuale (gardhet) etj.	m'	1,922.00	1.00 €	1,922.00 €
2	PUNËT TOKËSORE				13,470.0 €
2.1	Gërmimi i dheut te kategoris se III dhe IV me trashesi t=30cm, dhe bartja e materialit te germuar deri ne deponi me te afert.	m3	2,890.00	3.00 €	8,670.00 €
2.2	Nivelizimi dhe ngjeshja e nënbazes se rruges në tërë gjatësinë e saj me saktësi deri ne 2cm me grejder me modul te ngjeshjes 40-50MPa.	m²	9,600.00	0.50 €	4,800.00 €
3	KONSTRUKSIONI I TRASES SË RUGËS				118,028.0 €
3.1	Furnizimi, transporti, shtruarja, rafshimi dhe ngjeshja e materialit mbushes zhavorik te granular nga guri i thyer (0-63mm) me trashesi pas ngjeshjes t=15cm, ngjeshja te behet me cilindër 25tone deri ne modulën e ngjeshjes 50-60Mpa.	m3	1,445.00	12.00 €	17,340.00 €

Nr.	Specifikimi i punëve	Njësia (1)	Sasia (2)	Cmimi/ Njesi (3)	Gjithsejt (2x3)
3.2	Furnizimi, transporti, shtruarja, rafshimi dhe ngjeshja e materialit mbushës zhavorik të granulluar nga guri i thyer (0-31.5mm) me trashësi pas ngjeshjes t=15cm , ngjeshja të bëhet me cilindër 25tone deri në modulën e ngjeshjes 50Mpa.	m3	1,445.00	13.00 €	18,785.00 €
3.4	Furnizimi, transporti dhe punimi i shtresës së asfaltit me asfaltbeton AB-16 , me trashësi 7cm pas ngjeshjes adekuate. Karakteristikat e asfaltit: fraksionet e asfaltit >2mm... 45-82.5%, fraksionet e agregatit <2mm... 27-49%, pjesa për mbushjen e poreve <0.09mm... 3-6%, përqindja e fillerit ndaj agregatit 4-10%, materiali lidhës - bitumen B50/70... 5.3-6.5% dhe shkalla e ngjeshjes >97%. Garancioni i qendrueshmerisë së Asfaltit duhet të jetë minimum 5 vjeçar prej ditës kur është bërë pranimi teknik i punimeve.	m2	7,446.00	10.50 €	78,183.00 €
3.6	Furnizimi dhe vendosja e leshesës gypore Ø800mm për kalësimin e rrugës si dhe punimi i kokave nga betoni në të dy krahet	m	12.00	80.00 €	960.00 €
3.7	Marrja e mostrave të asfaltit për shqyrtim nga një laborator i caktuar nga autoriteti kontraktues (menaxheri i projektit) në vendet e caktuara po ashtu nga mbikqyrësi i projektit.	copë	8.00	25.00 €	200.00 €
3.8	Furnizimi dhe vendosja e sinjalizimit Vertikal nga qasja e rrugës dytësore e planifikuar për Asfaltim për kyqje në rrugën kryesore, Shenja e planifikuar është Shenja STOP e punuar sipas standardeve. Sinjalizimi të vendoset në rrugët dytësore që lidhen me rrugën kryesore.	copë	2.00	80.00 €	160.00 €
3.9	Furnizimi me material, transporti dhe shtruarja e bankinave në dy anët e rrugës me gjerësi nga 0.5m me trashësi 10cm pas ngjeshjes nga guri i thyer me fraksion (16-31.5mm).	m3	200.00	12.00 €	2,400.00 €

I. REKAPITULIMI

1	INÇIZIMET DHE PUNËT PARAPRAKE NË TEREN	6,344.0 €
2	PUNËT TOKËSORE	13,470.0 €
3	KONSTRUKSIONI I TRASES SË RUGËS	118,028.0 €
I. TOTALI (1+2+3):		137,842.00 €

NDERTIMI I RRUGËS Në Llukavc të thatë					
NDERTIMI I RRUGËS NË LLUKAVC TË THATË L=208m, b=3m, L=130m, b=3m L1=114m, b=3m L2=30m, b=3m, L3=30m, b=3m, L4=30m, b=3m, L5=20m, b=3m, L6=30m, b=3m, L7=30, b=3m, L8=10m, b=3m, L9=30m, b=3m, L10=20m, b=3m, L11=30m, b=3m, L12=53m, b=3m Zgjerime S=100m ²					
PARAMASA DHE PARALLOGARIA					
Gjatësia e rrugës :		L=735m	Gjerësia e asfaltit		b=3m
		Gjerësia e germimit:		b=4m	
Nr.	Specifikimi i punëve	Njësia (1)	Sasia (2)	Cmimi/ Njesi (3)	Gjithsejt (2x3)
1	INÇIZIMET DHE PUNËT PARAPRAKE NË TEREN				3,970.0 €
1.1	Mobilizimi i ndermarjes dhe rregullimi i punishtes per pune si dhe largimi i instalimeve te ndryshme (elektrike, uji dhe kanalizimi, ptk, kablllovice etj) ne punishte ne rast se ka ne ato hapësira dhe dislokimi i tyre ne vendet e caktuara nga institucionet perkatese. Te gjitha angazhimet dhe shpenzimet per dislokimin dhe rikyqjen e instalimeve ne rrejetin e qytetit i bart operatori ekonomik.	copë	1.00	1,500.00 €	1,500.00 €
1.2	Vendosja e shenjave te perkohshme vertikale dhe shenjave per kontrolle te trafikut gjate kryerjes se punimeve dhe sigurimi i komunikacionit gjate punimeve.	copë	1.00	1,000.00 €	1,000.00 €
1.3	Shenimi i trases si dhe percjellja e punimeve me matje gjeodezike gjate egzekutimit.	m'	735.00	1.00 €	735.00 €
1.4	Pastrimi i terenit ne pjeset anesore te ruges ne te dyja anet e saj nga shkuret, rrenjet e drunjeve egzistues me trashesi deri ne 40cm si dhe ndonje pengese eventuale (gardhet) etj.	m'	735.00	1.00 €	735.00 €
2	PUNËT TOKËSORE				5,715.0 €
2.1	Gërmimi i dheut te kategoris se III dhe IV me trashesi t=30cm, dhe bartja e materialit te germuar deri ne deponi me te afert.	m3	905.00	3.00 €	2,715.00 €
2.2	Nivelizimi dhe ngjeshja e nënbazes se rruges në tërë gjatësinë e saj me saktësi deri ne 2cm me grejder me modul te ngjeshjes 40-50MPa.	m ²	3,000.00	1.00 €	3,000.00 €
3	KONSTRUKSIONI I TRASES SË RUGËS				37,125.5 €
3.1	Furnizimi, transporti, shtruarja, rafshimi dhe ngjeshja e materialit mbushes zhavorik te granular nga guri i thyer (0-63mm) me trashesi pas ngjeshjes t=15cm, ngjeshja te behet me cilinder 25tone deri ne moduln e ngjeshjes 50-60Mpa.	m3	453.00	12.00 €	5,436.00 €

Nr.	Specifikimi i punëve	Njësia (1)	Sasia (2)	Cmimi/ Njesi (3)	Gjithsejt (2x3)
3.2	Furnizimi, transporti, shtruarja, rafshimi dhe ngjeshja e materialit mbushës zhavorik të granulluar nga guri i thyer (0-31.5mm) me trashësi pas ngjeshjes t=15cm , ngjeshja të bëhet me cilindër 25tone deri në modulën e ngjeshjes 50Mpa.	m3	453.00	13.00 €	5,889.00 €
3.4	Furnizimi, transporti dhe punimi i shtresës së asfaltit me asfaltbeton AB-16 , me trashësi 7cm pas ngjeshjes adekuate. Karakteristikat e asfaltit: fraksionet e asfaltit >2mm...45-82.5%, fraksionet e agregatit <2mm...27-49%, pjesa për mbushjen e poreve <0.09mm...3-6%, përqindja e filerit ndaj agregatit 4-10%, materiali lidhës - bitumen B50/70...5.3-6.5% dhe shkalla e ngjeshjes >97%. Garancioni i qendrueshmerisë së Asfaltit duhet të jetë minimum 5 vjeçar prej ditës kur është bërë pranimi teknik i punimeve.	m2	2,305.00	10.50 €	24,202.50 €
3.6	Furnizimi dhe vendosja e leshesës gypore Ø500mm për kalesen e rrugës	m	6.00	50.00 €	300.00 €
3.7	Marja e mostrave të asfaltit për shqyrtim nga një laborator i caktuar nga autoriteti kontraktues (menaxheri i projektit) në vendet eaktuara po ashtu nga mbikqyrësi i projektit.	copë	10.00	25.00 €	250.00 €
3.8	Furnizimi dhe vendosja e sinjalizimit Vertikal nga qasja e rrugës dytësore e planifikuar për Asfaltim për kyqje në rrugën kryesore, Shenja e planifikuar është Shenja STOP e punuar sipas standardeve. Sinjalizimi të vendoset në rrugët dytësore që lidhen me rrugën kryesore.	copë	2.00	80.00 €	160.00 €
3.9	Furnizimi me material, transporti dhe shtruarja e bankinave në dy anët e rrugës me gjerësi nga 0.5m me trashësi 10cm pas ngjeshjes nga guri i thyer me fraksion (16-31.5mm).	m3	74.00	12.00 €	888.00 €

I. REKAPITULIMI

1	INÇIZIMET DHE PUNËT PARAPRAKE NË TEREN	3,970.0 €
2	PUNËT TOKËSORE	5,715.0 €
3	KONSTRUKSIONI I TRASES SË RUGËS	37,125.5 €
I. TOTALI (1+2+3):		46,810.50 €

NDERTIMI I RRUGËS Kamer Loshi në Veriq					
NDERTIMI I RRUGËS Kamer Loshi në Veriq L=1870m, b=3m, L1=250m,b=3m dhe Zgjerime S=40m²					
PARAMASA DHE PARALLOGARIA					
Gjatësia e rrugës :		L=2120 m	Gjerësia e asfaltit		b=3m
		Gjerësia e germimit:			b=4m
Nr.	Specifikimi i punëve	Njësia (1)	Sasia (2)	Cmimi/ Njesi (3)	Gjithsejt (2x3)
1	INÇIZIMET DHE PUNËT PARAPRAKE NË TEREN				6,740.0 €
1.1	Mobilizimi i ndermarjes dhe rregullimi i punishtes per pune si dhe largimi i instalimeve te ndryshme (elektrike, uji dhe kanalizimi, ptk, kabllloviqe etj) ne punishte ne rast se ka ne ato hapesira dhe dislokimi i tyre ne vendet e caktuara nga institucionet perkatese. Te gjitha angazhimet dhe shpenzimet per dislokimin dhe rikyqjen e instalimeve ne rrjetin e qytetit i bart operatori ekonomik.	copë	1.00	1,500.00 €	1,500.00 €
1.2	Vendosja e shenjave te perkohshme vertikale dhe shenjave per kontrole te trafikut gjate kryerjes se punimeve dhe sigurimi i komunikacionit gjate punimeve.	copë	1.00	1,000.00 €	1,000.00 €
1.3	Shenimi i trases si dhe percjellja e punirneve me matje gjeodezike gjate egzekutimit.	m'	2,120.00	1.00 €	2,120.00 €
1.4	Pastrimi i terenit ne pjeset anesore te ruges ne te dyja anet e saj nga shkuret, rrenjet e drunjeve egzistues me trashesi deri ne 40cm si dhe ndonje pengese eventuale (gardhet) etj.	m'	2,120.00	1.00 €	2,120.00 €
2	PUNËT TOKËSORE				11,872.0 €
2.1	Gërmimi i dheut te kategoris se III dhe IV me trashesi t=30cm, dhe bartja e materialit te germuar deri ne deponi me te afert.	m3	2,544.00	3.00 €	7,632.00 €
2.2	Nivelizimi dhe ngjeshja e nënbazes se rruges në tërë gjatësinë e saj me saktësi deri ne 2cm me grejder me modul te ngjeshjes 40-50MPa.	m²	8,480.00	0.50 €	4,240.00 €
3	KONSTRUKSIONI I TRASES SË RUGËS				102,864.0 €
3.1	Furnizimi, transporti, shtruarja, rafshimi dhe ngjeshja e materialit mbushes zhavorik te granuluar nga guri i thyer (0-63mm) me trashesi pas ngjeshjes t=15cm, ngjeshja te behet me cilinder 25tone deri ne moduln e ngjeshjes 50-60Mpa.	m3	1,272.00	12.00 €	15,264.00 €

Nr.	Specifikimi i punëve	Njësia (1)	Sasia (2)	Cmimi/ Njesi (3)	Gjithsejt (2x3)
3.2	Furnizimi, transporti, shtruarja, rafshimi dhe ngjeshja e materialit mbushës zhavorik të granular nga guri i thyer (0-31.5mm) me trashësi pas ngjeshjes t=15cm, ngjeshja të bëhet me cilindër 25tone deri në modulën e ngjeshjes 50Mpa.	m3	1,272.00	13.00 €	16,536.00 €
3.4	Furnizimi, transporti dhe punimi i shtresës së asfaltit me asfaltbeton AB-16, me trashësi 7cm pas ngjeshjes adekuate. Karakteristikat e asfaltit: fraksionet e asfaltit >2mm...45-82.5%, fraksionet e agregatit <2mm...27-49%, pjesa për mbushjen e poreve <0.09mm...3-6%, përqindja e filerit ndaj agregatit 4-10%, materiali lidhës - bitumen B50/70...5.3-6.5% dhe shkalla e ngjeshjes >97%. Garancioni i qëndrueshmërisë së Asfaltit duhet të jetë minimum 5 vjeçar prej ditës kur është bërë pranimi teknik i punimeve.	m2	6,400.00	10.50 €	67,200.00 €
3.6	Furnizimi dhe vendosja e leshesës gypore Ø800mm për kalësimin e rrugës (dy rreze) si dhe punimi i kokave nga betoni në të krahet	m	12.00	80.00 €	960.00 €
3.7	Marrja e mostrave të asfaltit për shqyrtim nga një laborator i caktuar nga autoriteti kontraktues (menaxheri i projektit) në vendet e caktuara po ashtu nga mbikqyrësi i projektit.	copë	8.00	25.00 €	200.00 €
3.8	Furnizimi dhe vendosja e sinjalizimit Vertikal nga qasja e rrugës dytesore e planifikuar për Asfaltim për kryqje në rrugën kryesore, Shenja e planifikuar është Shenja STOP e punuar sipas standardeve. Sinjalizimi të vendoset në rrugët dytësore që lidhen me rrugën kryesore.	copë	2.00	80.00 €	160.00 €
3.9	Furnizimi me material, transporti dhe shtruarja e bankinave në dy anët e rrugës me gjerësi nga 0.5m me trashësi 10cm pas ngjeshjes nga guri i thyer me fraksion (16-31.5mm).	m3	212.00	12.00 €	2,544.00 €

I. REKAPITULIMI

1	INÇIZIMET DHE PUNËT PARAPRAKE NË TEREN	6,740.0 €
2	PUNËT TOKËSORE	11,872.0 €
3	KONSTRUKSIONI I TRASES SË RUGËS	102,864.0 €
I. TOTALI (1+2+3):		121,476.00 €